



Prishtinë, 15 tetor 2018  
Kodi i ZRRE-së: V\_1056\_2018

#### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

##### Duke u bazuar në:

- Nenit 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 15, nenin 25 dhe nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-084);
- Nenit 17 të Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 05/L-081);
- Vendimin V\_1037\_2018 të datës 24.09.2018 për Aprovimin e Planit Pesëvjeçar Zhvillimor dhe investues të operatorit të sistemit të shpërndarjes;
- Vendimet për lëshimin e Autorizimit Final V\_891\_2017; V\_923\_2018; V\_870\_2016; V\_881\_2017; V\_882\_2017 për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese nga BRE;
- Pëlqimin Elektroenergjetik nr. 3638 dt. 03.05.2016 të lëshuar nga KEDS SH.A për HC Orqusha dhe HC Dragash; dhe
- Pëlqimin Elektroenergjetik Nr.3373 dt. 06.05.2015; nr. 6050 dt. 19.07.2016 të lëshuar nga KEDS SH.A., për HC Brodi 3, HC Brodi 1 dhe HC Restelica 3,

##### në seancën e mbajtur me datë 15 tetor 2018 nxori këtë:

## V E N D I M

- I. OBLIGOHET** – KEDS SH.A. të merr të gjitha veprimet ligjore për ndërtimin e linjës nëntokësore Zhur – Dragash dhe stabilimenteve tjera 35kV në afatin më optimal të mundësh me qëllim të integritetit të BRE-ve, dhe sigurinë e furnizimit me energji elektrike jo më larg se fundi i vitit 2018.
- II. DETYROHET** – KEDS SH.A. të procedoj me vazhdimin e pëlqimeve energjetike të dhëna nga KEDS SH.A, në kohën kur gjeneratorët janë pajisur me autorizimet finale nga ZRRE-ja, duke respektuar kushtet teknike të dhëna në ato pëlqime.
- III.** Linja nëntokësore dhe stabilimentet tjera do të përfshihet në Bazën e Rregulluar të Aseteve për aq vite sa linja dhe stabilimentet do të jetë në shfrytëzim.
- IV.** Përshtatjet e kostos së vlerësuar të investimit kundrejt vlerës së realizuar të investimit do të bëhen gjatë përshtatjeve të rregullta vjetore.

## A r s y e t i m

- Bordi i ZRRE-së, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikacioneve për marrje të Autorizimit Final për ndërtim të Hidrocentraleve, në seancën e mbajtur me datë 27 shkurt 2017 ka nxjerr Vendim për lëshimin e Autorizimit Final V\_891\_2017 me ç'rast është lëshuar Autorizim Final shoqërisë N.P.N "Renelual Tahiri" Sh.P.K, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali HC Orqusha me kapacitet të instaluar prej 4





MW. Ndërsa në seancën e mbajtur me datë 29 mars 2018 ka nxjerr Vendim për lëshimin për Autorizimin Final V\_923\_2018 me ç'rast është lëshuar Autorizimi Final shoqërisë N.P.N "Renelual Tahiri" Sh.P.K, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali Dragash me kapacitet të instaluar prej 3.4 MW, në Komunën e Dragashit.

- Bordi i ZRRE-së, poashtu në seancën e mbajtur me 14 dhjetor 2016 ka nxjerr vendimin për lëshimin e Autorizimin Final V\_870\_2016, me ç rast është autorizuar shoqëria "Eurokos JH" SH.P.K., për ndërtimin kapaciteteve të reja gjeneruese nga Hidrocentrali HC Brodi 3, me kapacitet të instaluar prej 4.7 MW. Poashtu Bordi i ZRRE-së, në seancën e mbajtur me datë 09 shkurt 2017, ka lëshuar Vendimin për Autorizimin Final V\_881\_2017 për ndërtimin e HC Brodi 1, dhe Vendimin për Autorizimin Final V\_882\_2017 për ndërtimin e Hidrocentralit HC Restelica 3. Këto projekte janë autorizuar për ndërtim nga Bordi i ZRRE-së, pas përmbushjes së të gjitha kërkesave mjedisore, dhe ujore, të drejtat e shfrytëzimit të tokës, Lejet Ndërtimore të lëshuara nga Komuna e Dragashit, Pëlqimet Elektroenergjetike të lëshuara nga KEDS SH.A., dhe kërkesat tjera që lidhen me natyrën e projektit sipas legjislacionit në fuqi.
- ZRRE me datë 01.06.2018 nga shoqëria N.PN "RENELUAL TAHIRI" SH.P.K., ka pranuar kërkesën me urgjencë të shqyrtimit për moszbatimin e Pëlqimit Energjetik nr. 3638 të datës 03.05.2018 nga KEDS SH.A., për HC Orqusha dhe HC Dragash, të cilat janë autorizuar nga Bordi i ZRRE- së, me vendimin për Autorizimin Final V\_891\_2017 dhe V\_923\_2018, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Hidrocentralet.
- ZRRE me datë 25.06.2018 ka lëshuar përgjigjen me shkrim me të cilën e ka trajtuar kërkesën e palës me urgjencë për mosvazhdim të Pëlqimit Elektronergjetik nga KEDS SH.A.
- ZRRE në përgjigjen e saj ka sqaruar se sipas dispozitave ligjore të Rregullës për procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, një prej kushteve për të marrë Autorizimin Final është edhe marrja e pëlqimit për kyçje në rrjetin elektrik nga Operatori i Sistemit, të cilin dokument kompania N.P.N "Renelual Tahiri" Sh.P.K e ka marrë nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes KEDS me datë 03.05.2016. Kompania N.P.N "Renelual Tahiri" Sh.P.K me datë 28.02.2018 ka parashtruar kërkesë në KEDS për vazhdimin e Pëlqimit Elektroenergjetik nr. 3638 të datës 03.05.2016.
- ZRRE ka sqaruar se mbështetur në dispozitat ligjore të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, aplikuesit kanë të drejtën të kërkojnë kyçje të objekteve (gjeneratorëve) dhe pajisjeve të tyre energjetike në rrjetin e operatorit të sistemit, sipas dispozitave të Kodit të Rrjetit ose Kodit të Shpërndarjes, ndonjë kodit ose Rregulle tjetër në fuqi, dhe Operatori i Sistemit duhet të përgjigjet me shkrim brenda tridhjetë (30) ditësh ndaj çdo aplikimi për kyçje që është dorëzuar nga aplikuesit për kyçje në sistem.
- ZRRE në fund të përgjigjes ka theksuar se duke pasur parasysh se projekti është në proces të ndërtimit sipas Autorizimit të lëshuar nga ZRRE, e që është bazuar në dokumentet e ofruara nga aplikuesi përfshirë edhe Pëlqimin Elektroenergjetik të lëshur nga KEDS SH.A., konstaton se Operatori i Sistemit të Shpërndarjes – KEDS duhet që në afatin sa më shpejtë t'i mundësoj





vazhdimin e Pëlqimit Elektroenergjetik kompanisë N.P.N “Renelual Tahiri”, rrjedhimisht kyçjen në rrjetin elektrik, bazuar në vendimet Bordit të ZRRE-së V\_891\_2017 të datës 27.02.2017 dhe V\_923\_2018 të datës 29.03.2018.

- ZRRE nga shoqëria Eurokos JH SH.P.K., me datë 19.07.2018 ka pranuar njoftimin se janë në fazën e ndërtimit të hidrocentraleve HC Brodi 3, HC Bordi 1 dhe HC Restelica 3, që janë të Autorizuara nga ZRRE dhe për të cilat edhe pas parashtrimit të kërkesave për vazhdim të Pëlqimeve Energjetike në KEDS, nuk kanë marr përgjigje edhe pse janë bashkangjitur projekti kryesor i cili duhet të aprovohet nga KEDS para fillimit të punës.
- ZRRE me datë 02 gusht 2018 ka pranuar përgjigjen me shkrim nga KEDS SH.A, të cilën e ka vlerësuar dhe analizuar dhe pas vlerësimit nga Bordi i ZRRE-së, me datë 09.08.2018 ka lëshuar njoftimin mbi vlerësimin e përgjigjes me shkrim të KEDS dhe ka kërkuar që KEDS ti ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore për ndërtimin e linjës Zhur –Dragash dhe stabilimenteve tjera 35kW në afatin më optimal të mundshëm me qëllim të integritimit të BRE-ve, dhe sigurinë e furnizimit me energji elektrike për konsumatorët, jo më larg se fundi i vitit 2018.
- KEDS SH.A. me datë 14.08.2018 ka dërguar në ZRRE përgjigjen elektronike ka paraqitur komente shtesë të cilat janë vlerësuar nga ZRRE dhe me datë 15.08.2018 është lëshuar përgjigja elektronike ku është inkurajuar menaxhmentin e KEDS që të punoj në mënyrë konstruktive, duke theksuar se dështimi për të realizuar këtë linjë emergjente do të rrezikoj aftësinë e ZRRE në kryerjen e obligimeve ligjore që ka lëshuar Autorizime Finale për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese dhe integrimin e këtyre kapaciteteve në rrjet, dhe ka sqaruar se faza e parë e projektit të linjës Zhur – Dragash është emergjente, dhe ZRRE do të mbështes KEDS-in në implementimin e këtij projekti në cilëndo fazë të tij ashtu siç e ka thënë në të gjitha takimet e mbajtura me përfaqësuesit e KEDS SH.A.
- ZRRE me datë 29.08.2018 e ka ripërsëritur kërkesën e saj se nuk ka ndonjë format nga KEDS-i në lidhje me ecurinë e zhvillimeve të projektit të Dragash, për më tepër nuk ka zhvillime as në dhënien e pëlqimit energjetik për investitorin i cili është në pritje të marrjes së pëlqimit nga KEDS. Poashtu ka njoftuar se projektet të cilat Bordi i ZRRE-së, i ka trajtuar me prioritet si fazë emergjente e të cilat janë përfshirë edhe në të Hyrat Maksimale të Lejuara për vitet në vijim. Në vazhdim të kësaj shkresa ka theksuar se në përputhje me nenin 28 dhe 50 të Ligjit për Energjinë Elektrike, KEDS mban përgjegjësi për ofrimin e kyçeve në rrjetin e shpërndarjes, në pajtim me kërkesat për kyçje të përcaktuara me këtë ligj, rregullore dhe kodin e rrjetit të shpërndarjes.
- Bordi i ZRRE-së, me datë 24.09.2018 me vendimin V\_1037\_2018 ka aprovuar Planin pesëvjeçar Zhvillimor dhe investues të operatorit të sistemit të shpërndarjes, ku është përfshirë Linja nëntokësore 35kV, NS Zhur 35/10kV – NS Dragash 35/10kV si linjë emergjente dhe cila duhet të realizohet sa më parë.
- KEDS SH.A., në shkresën elektronike të dërguar me datë 04.10.2018 ka dhënë përgjigje lidhur me çështjen e ngritura, ku në lidhje me linjën emergjente Zhur –Dragash ka theksuar se pas vendimeve mbi parametrat e tarifave nga ZRRE, KEDS është në proces për të rishikuar planin





e tij të investimeve dhe duhet të rishikoj propozimin e tij fillestar në lidhje me draft planin e investimeve.

- Poashtu investimi nga KEDS i Linjës 35kV Zhur - Dragash është konsideruar nga ZRRE-ja, si investim emergjent me qëllim të kyçje së Gjeneratorëve të BRE-ve, të cilët priten të jenë në operim gjatë fundit të vitit 2018 apo periudhës së parë të vitit 2019.
- Kërkesa e ZRRE-së, për investim emergjent të linjës 35kV nga KEDS ka të bëjë me faktin se ndërtimi i nënstacionit të ri 110/35/10(20)kV nga Operatori i Sistemit të Transmetimit nuk mund të bëhet në periudhë afatshkurtër, dhe si rrjedhojë nuk do të mundësojë integrimin e BRE-ve të parapara të jenë në operim gjatë fundit të vitit 2018 dhe periudhës së parë të vitit 2019 dhe të mundësojë sigurinë e furnizimit për atë rajon.
- Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit të kërkesave të palëve shkresave të lëndës, vendimeve mbi lëshimin e Autorizimeve Finale, Pëlqimeve Elektroenergjetike të lëshuar nga KEDS SH.A., takimeve të shumta të mbajtura mes KOSTT, KEDS dhe ZRRE, ka vlerësuar ato dhe ka konstatuar se ndërtimi i linjës nëntokësore Zhur –Dragash nga KEDS SH.A., është emergjent duke parë zhvillimin e projekteve të Autorizuara nga ZRRE dhe investimet e bëra nga investitorët vendor në ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga BRE, e të cilit për më tepër kanë të nënshkruara edhe Marrëveshjet për Blerje të Energjisë dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- ZRRE-ja në përputhje me detyrimet ligjore do të monitorojë implementimin e këtij investimi, dhe në rast të moszbatimit të këtij Vendimi do të veproj në pajtim me nenin 57 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Vendimi iu dërgohet:**


- KEDS SH.A.,
- Palëve,
- Komunës së Dragashit,
- Ministrisë së Infrastrukturës,
- Arkivit të Rregullatorit.

**Bordi i ZRRE-së:**

  
Arsim Janova, u.d. Kryesues

  
Besim Sejfiqaj, anëtar

  
Selman Hoti, anëtar

  
Izet Rushiti, anëtar